

VENDIM
Nr.925, datë 2.9.2009

**PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE PËR INVESTIMET, TË VITIT 2009, NGA
MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË
PROVËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të pikës 3 të vendimit nr.787, datë 22.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një përdorim me efektivitet të fondeve për investime”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e përdorimit të fondeve për investimet të vitit 2009, me vlerë 4 800 000 (katër milionë e tetëqind mijë) lekë, nga Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Provës, për projektin “Rikonstrukcion i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës”, dhe vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të prokurimit.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha